

LIGJ

Nr.9928, datë 9.6.2008

PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e shërbimit shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë.
2. Ky ligj zbatohet nga/ndaj personat/personave fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e shërbimit shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Financimi i shërbimit shëndetësor stomatologjik publik

1. Në institucionet e shërbimit shëndetësor stomatologjik publik ofrohet falas shërbimi profilaktik dhe mjekues stomatologjik për:
 - a) personat nga mosha 0 deri 18 vjeç;
 - b) të sëmurët e shtruar dhe ata që trajtohen në institucione spitalore publike, për mjekime urgjence;
 - c) kategori të veçanta individësh që, me ligje dhe akte nënligjore të veçanta, përfitojnë shërbim shëndetësor stomatologjik falas.
2. Shteti merr përsipër të mbulojë pjesërisht:
 - a) shërbimin e urgjencave stomatologjike për moshat mbi 18 vjeç;
 - b) shërbime stomatologjike në Departamentin e Stomatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë;
 - c) shërbime stomatologjike në institucionet stomatologjike publike.
3. Masa dhe mënyra e kontributit të shtetit për shërbimet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3
Shërbimi i urgjencës stomatologjike

1. Shërbimi i urgjencës stomatologjike ofrohet në:
 - a) institucionet publike shëndetësore spitalore;
 - b) institucionet publike shëndetësore stomatologjike ambulatorë.

2. Në ato institucione shëndetësore, ku nuk mund të ofrohet shërbimi i urgjencës, sipas pikës 1 të këtij neni, lidhen kontrata shërbimi me subjekte, që ofrojnë shërbim stomatologjik privat.

Neni 4

Shërbimi shëndetësor stomatologjik në institucionet arsimore

1. Shërbimi profilaktik, diagnostikues dhe edukimi shëndetësor stomatologjik ofrohen në të gjitha institucionet arsimore të nivelit të detyrueshëm.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës nxjerrin udhëzimin e përbashkët për funksionimin dhe organizimin e këtij shërbimi në këto institucione arsimore.

KREU II

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE STOMATOLOGJIKE, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TYRE

Neni 5

Institucionet që ofrojnë shërbim shëndetësor stomatologjik

1. Shërbimi shëndetësor stomatologjik ofrohet nga:
 - a) institucionet shëndetësore stomatologjike publike;
 - b) institucionet shëndetësore stomatologjike private.
2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të institucioneve shëndetësore stomatologjike përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 6

Licencimi

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, ushtrojnë veprimtarinë në shërbimin shëndetësor stomatologjik vetëm pas licencimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë ose autoriteteve të autorizuar prej saj.
2. Procedurat dhe kriteret e licencimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Personeli i shërbimit shëndetësor stomatologjik

1. Shërbimi shëndetësor stomatologjik ofrohet nga personeli:
 - a) mjek stomatolog;
 - b) ndihmësmjek stomatolog;
 - c) laborant dentar.
2. Personeli i shërbimit shëndetësor stomatologjik e ushtron veprimtarinë në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministri i Shëndetësisë.

KREU III

MBIKËQYRJA NË SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK

Neni 8

Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik

1. Mbikëqyrja në shërbimin shëndetësor stomatologjik kryhet nga Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik.

2. Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik organizohet dhe funksionon në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik është organi ekzekutiv i specializuar për kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.
4. Struktura dhe organika e Inspektoratit Shëndetësor Stomatologjik miratohen nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë.
5. Rregullat e funksionimit të Inspektoratit Shëndetësor Stomatologjik miratohen nga Ministri i Shëndetësisë.

KREU IV KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 9

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen:
 - a) shkelja e nenit 6, me gjobë 50 000 lekë dhe me ndërprerje të veprimtarisë deri në plotësimin e dokumentacionit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - b) shkelja e rregullave të përmendura në pikën 2 të nenit 7 të këtij ligji, me gjobë deri në 50 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me mbyllje të veprimtarisë.
2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobave është Inspektorati Shëndetësor Stomatologjik.

Neni 10 Ankimi

Procedurat për vënien e gjobave për kundërvajtjet administrative dhe ankimi për to bëhen në përputhje me ligjin nr.7679, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", të ndryshuar.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 2 pika 3 dhe 6 pika 2 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë të nxjerrë urdhrat në zbatim të neneve 5 pika 2, 7 pika 2 dhe 8 pika 5 të këtij ligji.
3. Ngarkohet Ministria Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 4 pika 2 të këtij ligji.

Neni 12 Shfuqizime

Ligji nr.8167, datë 21.11.1996 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5784, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

L I G J

Nr.8167, datë 21.11.1996

PER SHERBIMIN SHENDETESOR STOMATOLOGJIK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991
"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë
në fushën e shërbimit shëndetësor stomatologjik, **privat dhe publik**.

Neni 2

Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit përcakton strategjinë
e zhvillimit të shërbimit stomatologjik, mënyrën e organizimit,
normat dhe rregulloret e funksionimit të tyre dhe për sektorin
publik formën e shërbimeve si dhe strukturat e institucioneve.

Neni 3

Shërbimi shëndetësor stomatologjik profilaktik dhe mjekues mbulohet nga buxheti i shtetit.

1. Plotësisht:

- a) Për moshat nën 18 vjeç.
- b) Për të shtruarit dhe ata që trajtohen në institucione spitalore shtetërore në rastet e mjekimeve urgjente.
- c) Për kategori individësh të përcaktuara në dispozita ligjore.

2. Sipas përcaktimit të bërë nga Këshilli i Ministrave;

- a) Për shërbimin e departamentit të stomatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë.
- b) Për shërbimin e urgjencave stomatologjike për moshat mbi 18 vjeç.

Ky shërbim organizohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ambientit në institucione shkollore, si dhe në institucionet shëndetësore publike.

Institucionet stomatologjike private janë të detyruara të realizojnë këtë shërbim kundrejt çmimeve të përcaktuara në kontratat e shërbimit të lidhura ndërmjet palëve.

Neni 4

Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, përcaktojnë rregulloret përkatëse për shërbimet shëndetësore stomatologjike në institucionet shkollore.

Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit detyrohet të sigurojë inventarin, materialet e konsumit të nevojshëm për kryerjen e këtij shërbimi si dhe mbajtjen në gadishmëri të këtij inventari.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve detyrohet të sigurojë mjediset e kushtet e nevojshme të përshtatshme për shërbimin stomatologjik.

Neni 5

Organet qendrore të administratës shtetërore dhe ato të pushtetit lokal, shoqatat dhe fondacionet mund të organizojnë shërbimin shëndetësor stomatologjik për kategori të caktuar individësh me buxhetin e tyre.

KREU II

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE STOMATOLOGJIKE, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TYRE

Neni 6

Në institucionet shëndetësore stomatologjike përfshihen:

- Institucionet stomatologjike publike
- Institucionet stomatologjike private

Neni 7

Institucionet shëndetësore stomatologjike private hapen me kërkesën e personave juridikë dhe fizikë vendas e të huaj, duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit.

Neni 8

Institucionet shëndetësore spitalore, plotësimin e nevojave me shërbim stomatologjik (si me specialistë e ndihmës-specialistë stomatologë etj.) e realizojnë si rregull me subjekte private sipas çmimeve të përcaktuara në kontratat e shërbimeve ose nëpërmjet shërbimit shëndetsor stomatologjik shtetëror.

KREU III

TE DREJTAT PER USHTRIMIN E PROFESIONIT

Neni 9

Të drejtën për ushtrimin e profesionit në fushën e stomatologjisë e kanë personat juridikë e fizikë vendas e të huaj.

Neni 10

Personat juridikë dhe fizikë vendas e të huaj janë të detyruar të pajisen me licencë profesionale, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit:

- a) për ushtrimin e veprimtarisë private në fushën e stomatologjisë;
- b) për hapjen e institucioneve stomatologjike private (në trajtën e klinikave komplekse dentare);
- c) për tregtimin e materialeve dhe aparaturave dentare.

Neni 11

Shërbimi shëndetësor stomatologjik publik dhe privat kontrollohet nga strukturat e:

- a) Inspektoratit sanitar shtetëror, bazuar në ligjin “Për inspektoratin sanitar shtetëror”.
- b) Specialistëve të Drejtorisë së Shëndetit Publik.
- c) Përfaqësuesve të shoqatës së stomatologëve.

Neni 12

Veprimtaria profilaktike, mjekuese dhe ortodontike në institucionet stomatologjike publike kryhet nga mjekët stomatologë dhe asistentët përkatës.

Neni 13

Të drejtën për t'u pajisur me **licencë** për ushtrimin e profesionit pa praninë e mjekut e gëzojnë ndihmësmjekët stomatologë me arsimin e mesëm profesional, kur kanë punuar me pacientë si asistentë të mjekut mbi 10 vjet.

Neni 14

Laborantet e shërbimit të ortopedisë gëzojnë të drejtën e pajisjes me **licencë** për ushtrimin e profesionit si laborant dentar. Laborantët dentarë nuk u lejohej të kryejnë veprimtari mjekuese me pacientë.

KREU IV

SPECIALIZIMI DHE KUALIFIKIMI I PUNONJESVE TE SHËRBIMIT STOMATOLOGJIK

Neni 15

Departamenti i Stomatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë është institucioni që përgatit specialistët e lartë të profileve të stomatologjisë.

Neni 16

Të drejtën e kualifikimit dhe të specializimit të specialistëve të mesëm e të lartë e kanë edhe personat juridikë, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe me autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit dhe nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimeve Shkencore.

KREU V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 17

Punonjësit e shërbimit stomatologjik janë të detyruar të afishojnë çmimet dhe shërbimet që ata ofrojnë.

Neni 18

Mjekët stomatologë privatë janë të lirë të bëjnë reklamë personale, e cila duhet të jetë legale dhe e vërtetë, për të përcjellë mesazhe të ndryshme për tipat e trajtimit, specializimit dhe kualifikimet.

Neni 19

Shkeljet e rregullave të parashikuara në nenet 3, 4, 10 dhe 17 të këtij ligji, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga autoritetet e përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji si vijon:

- a) Për ushtrim profesional në fushën e stomatologjisë pa licencë me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë.
- b) Për hapjen e institucioneve shëndetësore stomatologjike private pa licencë me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 mijë lekë.
- c) Për mosrealizimin e kushteve të nevojshme për ushtrimin e shërbimit stomatologjik në instituicione shkollore me gjobë nga 15 000 deri në 20 000 mijë lekë.
- ç) Për mosafishimin e çmimeve të shërbimit me gjobë nga 1000 deri në 5000 lekë.
- d) Për mosrealizimin e shërbimit shëndetësor stomatologjik të kërkuar për moshat nën 18 vjeç, të të shtruarve në spitale dhe kategorive të përcaktuara në dispozitat ligjore, ose mospërbushjen e detyrimeve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve për përbushjen e këtij shërbimi, me heqjen e licencës profesionale ose me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë.

Neni 20

Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative të parashikuar në dispozitat e mësipërme bëhet sipas ligjit nr.7679, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", me ndryshimet përkatëse.

Neni 21

Ministria e Shëndetësisë dhe Ambientit, Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve përgatisin dhe miratojnë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 22

Të gjithë dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1661, datë 5.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

L I G J

Nr.8414, DATE 1.10.1998

PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN Nr.8167, DATE 21.11.1996 "PER SHERBIMIN SHENDETESOR STOMATOLOGJIK"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

NENI 1

Në ligjin nr.8167, datë 21.11.1996 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", neni 3 ndryshohet si vijon:

"Shërbimi shëndetësor stomatologjik, profilaktik dhe mjekues mbulohet nga buxheti i shtetit:

1. Plotësisht:

- a) për moshat nën 18 vjeç;
- b) për të shtruarit dhe për ata që trajtohen në institucionet spitalore, shtetërore, për rastet e mjekimeve urgjente;
- c) për kategori individësh, të përcaktuara në dispozita ligjore;
- ç) për shërbimin e urgjencave stomatologjike, për moshat mbi 18 vjeç, sipas përcaktimeve të bëra nga Ministria e Shëndetësisë;
- d) për trajtime mjekësore stomatologjike, në terapi dhe kirurgji, në departamentin e stomatologjisë së Fakultetit të Mjekësisë.

2. Pjesërisht, me tarifa të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe të miratuara nga Ministria e Financave:

- a) për shërbime stomatologjike, ortopedike në departamentin e stomatologjisë së Fakultetit të Mjekësisë;
- b) për shërbime stomatologjike në institucionet shtetërore, pa subvencion nga shteti ose me drejtim ekonomik."

NENI 2

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Shërbimi shëndetësor stomatologjik, publik dhe privat, kontrollohet nga strukturat e:

- shërbimit stomatologjik në Ministrinë e Shëndetësisë;
- shërbimit stomatologjik të drejtorive të shëndetit publik;
- Inspektoratit Sanitar Shtetëror, të bazuar në ligjin nr.7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror";
- Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet në Ministrinë e Shëndetësisë, të bazuar në ligjin nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese";
- Inspektoratit Epidemiologjik, bazuar në ligjin nr. 7761, datë 18.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjithëse".

Organet e mësipërme mund të bashkëpunojnë me "Shoqatën e stomatologëve", duke aktivizuar në grupet e kontrollit, të organizuara prej tyre, specialistë të rekomanduar nga

shoqata."

NENI 3

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Veprimtaria profilaktike, mjekuese dhe diagnostikuese ortodontike dhe procesi diagnostikues në institucionet stomatologjike publike kryhet nga mjekët stomatologë dhe asistentët përkatës."

NENI 4

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"Shkeljet e rregullave të parashikuara në nenet 3, 4, 8, 10, 14 dhe 17 të këtij ligji, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga organet e përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, si më poshtë:

a) Për ushtrim profesioni pa licencë në fushën e stomatologjisë, me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë dhe në rast mospajisjeje me licencë brenda një afati 2 mujor, me pezullimin e veprimtarisë dhe deri në mbylljen e klinikës.

b) Për hapjen e institucioneve shëndetësore stomatologjike private pa licencë, me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë dhe në rast mospajisjeje me licencë, brenda një afati 2 mujor, me pezullimin e veprimtarisë dhe deri në mbylljen e institucionit.

c) Për mosrealizimin e kushteve të nevojshme për ushtrimin e shërbimit stomatologjik në institucionet shkollore, me gjobë nga 10 000 deri në 20 000 lekë, deri në pezullimin e veprimtarisë.

ç) Për mosafishimin e çmimeve të shërbimit, me gjobë nga 1 000 deri në 5 000 lekë.

d) Për mosrealizimin e shërbimit stomatologjik për moshat nën 18 vjeç, të të shtruarve në spitale, të kategorive të përcaktuar në dispozitat ligjore dhe urgjencat për të rritur, me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë.

dh) Për mospërmbushjen e detyrimeve ndaj kontratës së lidhur ndërmjet palëve për realizimin e shërbimit, me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë ose me heqjen e licencës.

e) Për ushtrimin e veprimtarisë mjekuese me pacientë nga laborantët dentarë, me gjobë nga 10 000 deri 50 000 lekë ose me heqjen e licencës."

NENI 5

Në të gjitha dispozitat e ligjit nr.8167, datë 21.11.1996 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", fjalët "Ministria e Shëndetësisë dhe e Mjedisit" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Shëndetësisë", kurse fjalët "Ministria e Arsimit dhe Sporteve" dhe "Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Arsimit dhe e Shkencës".

NENI 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2234, datë 15.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

LIGJ

Nr.9153, date 6.11.2003

PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE LIGJIN NR.8167, DATE 21.11.1996 "PER SHERBIMIN SHENDETESOR STOMATOLOGJIK", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8414, DATE 1.10.1998

Ne mbështetje te neneve 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Ne ligjin nr.8167, date 21.11.1996 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", ndryshuar me ligjin nr.8414, date 1.10.1998, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Ne nenin 10, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:
"ç) për kualifikimin e specializimin e specialisteve te mesëm e te larte dhe për hapjen e shkollave profesionale qe përgatisin specialiste te fushës se stomatologjisë, sipas legjislacionit për arsimin dhe formimin profesional."

Neni 2

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1

Personat juridike dhe fizike, vendas e te huaj, qe janë te pajisur me licence profesionale, sipas shkronjës "c" te nenit 10 te këtij ligji, për çdo importim te bere, pajisen me leje importi për materiale dhe aparatura dentare nga Ministria e Shëndetësisë. Licenca e importit është automatike.

Ministri miraton rregulloren përkatëse."

Neni 3

Neni 11 ndryshohet si me poshtë:

"Neni 11

Shërbimi shëndetësor stomatologjik, publik dhe privat, kontrollohet nga Inspektorati Stomatologjik Shtetëror."

Neni 4

Pas kreut III shtohet kreu III/1 me këtë përmbajtje:

"KREU III/1
STRUKTURAT E KONTROLLIT TE SHERBIMIT STOMATOLOGJIK

Neni 14/1

Ne varësi te Ministrit te Shëndetësisë krijohet Inspektorati Stomatologjik Shtetëror, si organi me i larte i kontrollit stomatologjik. Struktura, rregullat e funksionimit te Inspektoratit Stomatologjik Shtetëror, ne nivel qendror dhe vendor, miratohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 14/2

Inspektorati Stomatologjik Shtetëror është organi ekzekutiv i specializuar, qe kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe te akteve nënligjore ne shërbimin stomatologjik publik dhe privat.

Neni 14/3

Inspektorati Stomatologjik Shtetëror, ne kryerjen e detyrave te tij, bashkëpunon me:
Inspektoratin Sanitar Shtetëror;
Inspektoratin Epidemiologjik;
Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet.
Koordinimi i Punës se këtyre organeve behet me urdhër te Ministrit te Shëndetësisë."

Neni 5

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4017, date 2.12.2003 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë, Alfred Moisiu